



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE  
KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN  
PËRFUNDIMTAR  
NË KUALIFIKIMIN PROFESIONAL  
“NDËRTIM”**

**(Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK)**

**TIRANË, 2024**

Në përfundim të kualifikimit profesional “Ndërtim”, **Niveli IV në KSHK, referuar Niveli IV në KEK**, individët i nënshtrohen Provimit Përfundimtar të praktikës profesionale të integruar, në zbatim të udhëzimit “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në Arsimin dhe Formimin Profesional”.

**Programi orientues** për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional “Ndërtim”, përmban kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 13-të, që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të nxënësve.

Për drejtuesit e të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të individëve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e nxënësit/es në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në arsimin pas të mesëm dhe të lartë.

Gjatë përgatitjes së individëve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësimdhënësit të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

### **Përmbajtja e programit për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar**

**Programi orientues** për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikimin “Ndërtim”, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

**a) Lista e kompetencave profesionale** për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë:

<b>Nr.</b>	<b>Kompetenca profesionale</b>	<b>Detyrat e punës</b>	<b>Pikët</b>
1	Të kryejë punime me programet kompjuterike <i>AutoCAD</i> dhe <i>EXCEL</i> .	<b>Detyra 1</b> - Punime me programet kompjuterike <i>AutoCAD</i> dhe <i>EXCEL</i> .	20
2	Të organizojë punimet dhe piketimin në terren.	<b>Detyra 2</b> - Organizimi i punimeve dhe piketimi në terren.	20
3	Të ndjekë punimet për zbatimin e projektit.	<b>Detyra 3</b> - Ndjekje punimesh për zbatimin e projektit.	35

Nr.	Kompetenca profesionale	Detyrat e punës	Pikët
4	Të plotësojë dokumentacionit teknik për ndërtimin e objektit.	<b>Detyra 4</b> - Plotësimi i dokumentacionit teknik për ndërtimin e objektit.	25
<b>Shuma</b>			<b>100</b>

**b) Skema e vlerësimit me nota:**

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

**Shënime:**

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “*poste pune*”, grupe pune ose në mënyrë individuale, në një objekt ndërtimi ose në bazën prodhuese të shkollës.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Rregulloren e Zhvillimit të Provimeve Përfundimtare në fuqi.
- Në çdo detyrë respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë domosdoshmërisht të përfshira në vlerësim.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësim dhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Komisioni i vlerësimit duhet të hartojë paraprakisht pyetjet për bashkëbisedimin profesional.
- Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrjen e komisionit duke u testuar/vlerësuar në një nga proceset e punës për çdo detyrë, kjo edhe për shkak të kohës së kufizuar 3 orë të provimit praktik.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme. Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për produktin/procesin përfundimtar.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përmbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.

**Udhëzime për realizimin e Detyrës 1 - “Punime me programet kompjuterike *AutoCAD* dhe *EXCEL*.”**

Kjo detyrë do të realizohet në klasën/laboratorin e praktikës së ndërtimit.

Nxënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për ndërtimin e figurave gjeometrike nëpërmjet komandave të programit kompjuterik *AutoCAD*.

Nxënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për krijimin dhe përcaktimin e shtresave, ngjyrave, tipave të vijave dhe përmasimin.

Nxënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për përdorimin e blloqeve të vizatimit në programin kompjuterik *AutoCAD*.

Nxënësit duhet të punojnë në grup/individuale për: realizimin e vizatimeve të ndërtimit me programin *AutoCAD*, si dhe llogaritjen e vlerave të preventivit/situacioneve të objektit ndërtimor me programin *EXCEL* deri në printimin e tyre.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të aftësive të çdo nxënësi.

Për realizimin e detyrës mësuesi i praktikës duhet të sigurojë: mjediset, (laboratorin e praktikës së ndërtimit), pajisjet dhe materialet, kompjuterë personalë me programet *AutoCAD* dhe *EXCEL* të instaluar, skica të gatshme dhe fletë nga projekt zbatimi të objektit ndërtimor, projekt zbatimi dhe librat e masave të objektit ndërtimor, video-projektor, flip-çart, markera me ngjyra, printer, fotate letrash, manuale të punimeve të ndërtimit në fuqi, manual i përdorimit të programeve *AutoCAD* dhe *EXCEL* etj.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

### **Udhëzime për realizimin e Detyrës 2 - “Organizimi i punimeve dhe piketimi në terren“.**

Kjo detyrë do të realizohet në terren.

Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë individuale për vendosjen e tabelës treguese dhe ndjekjen e punimeve për rrethimin e të sigurisë në punë dhe ruajtjen e mjedisit.

Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë individuale/grup për ndjekjen e punimeve të modinave.

Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë individuale/grup për piketimin e akseve sipas fletës së planit të themeleve.

Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë individuale për leximin, interpretimin e kuotës  $\pm 0,00$  të objektit lidhur me kuotë absolute të shënuar në planin e përgjithshëm të azhornuar.

Për realizimin e detyrës mësuesi i praktikës duhet të sigurojë: terren ndërtimi, plan i përgjithshëm i azhornuar i objektit, plan organizim i punimeve të objektit, projekt zbatimi i objektit, tabelë treguese e gatshme me të dhënat e objektit, fletë me planin e akseve për piketimin e objektit, materiale vizuale demonstruese, dokumentacion përkatës për piketimin e akseve dhe shënimin e kuotës  $\pm 0,00$  të objektit, udhëzues për rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit etj..

Nxënësit organizohen individualisht/grupe pune dhe angazhohen në veprimtari konkrete. Ata nën mbikëqyrjen e mësuesit të praktikës ndjekin organizimin e punimeve dhe piketimin në terren.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

### **Udhëzime për realizimin e Detyrës 3 - “Ndjekje punimesh për zbatimin e projektit”.**

Kjo detyrë duhet të realizohet në një objekt ndërtimi.

Nxënësit duhet të kryejnë njërën nga proceset si: ndjekjen e punimeve për gjurmimin e gropës së

plintave, ndjekjen e punimeve për konstruksionit mbajtës me skelet prej betoni të armuar nën kuotën  $\pm 0,00$  (nëntokë) dhe mbi kuotën  $\pm 0,00$  (mbi tokë), ndjekjen e punimeve të muraturës dhe izolimit, ndjekjen e punimeve të rifiniturës.

Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete për ndjekjen e njëjës prej proceseve si: punimet për gjurmimin e gropës së plintave, konstruksionit mbajtës dhe rifiniturës së objektit, si dhe për interpretimin e fletëve arkitektonike me detajet dhe konstruktive të projekt zbatimit.

Mësuesi i praktikës duhet të udhëzojë dhe ndjekë respektimin e rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit për ndjekjen e punimeve të gjurmimit, konstruksionit mbajtës dhe rifiniturës së objektit.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së aftësisë për ndjekjen e punimeve për gjurmimin e gropës së plintave, konstruksionit mbajtës dhe rifiniturës së objektit, si dhe për interpretimin e detajeve të projekt zbatimit.

Për realizimin e detyrës duhet të sigurohen mjetet dhe pajisjet e punës si: mjedis objekt ndërtimi, plan i përgjithshëm i azhornuar i objektit, plan organizim i punimeve të objektit, projekt zbatim me fletët arkitektonike me detajet, konstruktive të objektit, materiale vizuale demonstruese, dokumentacion përkatës për punimet e gjurmimit, e konstruksionit mbajtës dhe rifiniturës së objektit, udhëzues për rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit etj.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.

#### **Udhëzime për realizimin e Detyrës 4 - "Plotësimi i dokumentacionit teknik për ndërtimin e objektit."**

Kjo detyrë realizohet në një objekt /laborator ndërtimi.

Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete për ndjekjen e njëjës prej proceseve si: hartimin e librit të matjeve, preventivin paraprak dhe situacionin e punimeve të ndërtimit, si dhe hartimin e planit kalendarik të punimeve me grafikun e fuqisë punëtore.

Mësuesi i praktikës duhet të sigurojë materiale konkrete si: plan organizimi i punimeve, projekt zbatimi i objektit konkret, projekti i një objekti dhe manuale të ndërtimit në fuqi.

Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete për: hartimin e librezës së masave, preventivit, situacionet pjesore për të gjitha llojet e punimeve të ndërtimit, situacionin përfundimtar, planit kalendarik të punimeve e grafikut të fuqisë punëtore dhe plotësimin e dokumentacionit teknik e ligjor.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së aftësisë për: hartimin e librit të matjeve, preventivit paraprak dhe situacionit për të gjitha llojet e punimeve të ndërtimit; planit kalendarik të punimeve e grafikut të fuqisë punëtore dhe plotësimin e dokumentacionit teknik e ligjor.

Mësuesi i praktikës duhet të sigurojë materiale konkrete si: plan organizimi i punimeve, projekt zbatimi i objektit konkret, projekti i një objekti dhe manuale të ndërtimit në fuqi.

Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete për: hartimin e librezës së masave, preventivit, situacionet pjesore për të gjitha llojet e punimeve të ndërtimit, situacionin përfundimtar, planit kalendarik të punimeve e grafikut të fuqisë punëtore dhe plotësimin e dokumentacionit teknik e ligjor.

Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e të gjitha proceseve të punës.

Vlerësimi i nxënësve bëhet më anë listës së kontrollit të përgatitur më parë.